



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.1140/12**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditëses – të kundërpaditurës S. R. nga fshati G., Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.Y. K. nga Prizreni, kundër të paditurit - kundërpaditësit I. M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B. N. nga Prizreni, për shkak të borxhit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 17.09.2014, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses S. R. nga fshati G., Komuna e Prizrenit dhe obligohet i padituri I. M. nga Prizreni, që paditëses në emër të borxhit t'ia paguajë shumën prej **7,000.00 euro**, me kamatë ligjore sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të posaçëm, duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të padisë (17.12.2012) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.**

**II. Konsiderohet se kundërpadia e të paditurit - kundërpaditësit I. M. nga Prizreni, e parashtruar kundër paditëses – të kundërpaditurës S. R. nga fshati G., Komuna e Prizrenit, në këtë çështje juridike kontestimore, është tërhequr.**

**III. Obligohet i padituri që t'ia paguajë shpenzimet procedurale paditësit në lartësi prej **675.00 euro**, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.**

**A r s y e t i m**

Paditësja S. R. nga fshati G. Komuna e Prizrenit ka parashtruar padinë kundër të paditurit I. M. nga Prizreni rruga... p.nr., përmes të cilës ka theksuar se me të paditurin kanë lidhur kontratë për shitblerjen e palujtshmërisë – parcelës kadastrale nr.1893/1 ZK L., në sipërfaqe prej 1.457 m<sup>2</sup>, dhe shumën të përgjithshme prej 9.000 € të cilat ka marrë obligim që ti paguajë dhe atë shumën prej 4.000 € me 30.06.2012, ndërsa 5.000 € me 30.12.2012. Mirëpo i padituri ka refuzuar që ta kryej obligimin e vetë, andaj ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin që të paguaj borxhin në shumë prej 9.000 €, si dhe shpenzimet e procedurës.

Seanca e shqyrtimit kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur me datën 17.09.2014.

Në këtë seancë i autorizuari i paditëses av. Y. K. nga Prizreni ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë ndërsa në fjalën e fundit ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurin në pagesën e borxhit në shumë prej 7.000 €, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 135 € për padi dhe për katër seanca të mbajtura nga 135 € në përgjithësi shumë prej 675 €.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi ndërsa përmes të autorizuarit të tij av. B. N. nga Prizreni ka parashtruar kundërpadi në të cilën ka theksuar se i padituri – kundërpaditësi ka paguar pjesën më të madhe të çmimit të kontraktuar dhe pasi që kontrata ka qenë për pjesën prej 1.457 m<sup>2</sup> dhe kjo sipërfaqe nuk i përgjigjet në teren sepse në teren sipërfaqja është 8-10 ari, andaj shuma e paguar ka tejkaluar shumë e duhur për pagesë dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kundërpadinë dhe ta obligojë paditësen – të kundër paditurin që t'ia kthejë shumë e cila është paguar më shumë se sa që duhet për sipërfaqen e kontraktuar të bazë të kontratës së shitblerjes. Ndërsa nuk ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.09.2014 edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditëses është **e bazuar**.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: kontratën për shitblerjen e palujtshmërisë të lidhur në mes këtu palëve ndërgjyqësve të datës 08.02.2012; CD-në e ofruar nga ana të paditurit-kundërpaditësit si dhe është bërë dëgjimi i dëshmitares Xh. R..

Nga leximi i kontratës së shitblerjes së palujtshmërisë të lidhur në mes këtu palëve ndërgjyqësve të datës 08.02.2012, gjykata ka konstatuar se e njejta është lidhur në mes të S. R. dhe I. M. (këtu palëve ndërgjyqëse) për shitblerjen e paluajtshmërisë-parcelës kadastrale nr.1893/1 ZK L., në sipërfaqe prej 1.457 m<sup>2</sup> dhe blerësi ka marrë obligim që shumë e mbetur prej 9000 € t'ia paguajë shitësit një pjesë më datë 30.06.2012 dhe pjesën tjetër më 31.12.2012.

Nga leximi-shikimi i CD-së së ofruar nga ana të paditurit- kundërpaditësit, gjykata ka konstatuar se i padituri I. M. pa lidhjes së kontratës së datës 08.02.2012, dhe pas lidhjes së kësaj kontrate ia ka paguar paditëses shumë prej 2000 € në shtëpinë e saj, dhe pjesën tjetër të mbetur prej 7000 € është zotuar se do ta paguajë deri në fund të viti 2012.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares Xh. R. nga fshati G., Komuna e Prizreni, të cilës dëshmi gjykata i falë besimin, e cila para gjykatës ka deklaruar se I. M. ia ka borxh nënës së saj këtu paditëses në emër të shitjes së tokës shumë prej 7000 €, pasi që 2000 euro ia ka paguar pasi që është lidhur kontrata te avokati, të cilat të holla ia ka dhënë në shtëpinë e saj dhe për këtë është incizuar me kërkesën e I., të cilën kontratë e ka nënshkruar nëna e saj dhe I. M., ndërsa për pjesën tjetër të borxhit janë marrë vesh përmes avokatit që ta paguaj brenda 4 deri në 6 muaj, pasi që I. ka deklaruar se nuk ka mundësi që ta paguajë menjëherë dhe i njëjti vazhdimisht ka shkuar në shtëpinë e tyre si

mik dhe iu ka thënë se “ nëse nuk mund të paguajë borxhin, do t’ia sigurojë banimin-strehimin me qëllim që të mos mbeten në rrugë”. Poashtu ka deklaruar se me nënën e saj jetojnë me qira dhe këtë fakt e din edhe I. M., i cili i ka vizituar dhe iu ka thënë se dëshiron të merr kredi për ta paguar borxhin, por nuk i lejohet kredia, ndërsa shtëpinë e ka ndërtuar në tërësi. Dëshmitarja të gjitha këto i ka të njohura pasi që ka qenë e pranishme në zyrën e avokatit kur është lidhur kontrata dhe ka kërkuar nga avokati që ta ndihmojë në nxjerrjen e kredisë.

Pasi që i padituri nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka ofruar prova që do të kundërshtonin pretendimet e palës paditëse, gjykatës i rezultojë si i provuar fakti se i padituri i ka borxh paditëses shumë e lartcekur, të cilën edhe ka obligim që t’ia paguajë.

Me nenin 17 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se “*pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij*”, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se “*kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla ...*”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e precizuar e paditëses duhet të aprovohet në tërësi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se palët ndërgjyqëse më datën 08.02.2012 kanë lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore për shitblerjen e paluajtshmërisë-parcelës kadastrale nr.1893/1 ZK L., në sipërfaqe prej 1.457 m2 dhe blerësi ka marrë obligim që shumë e mbetur prej 9000 € t’ia paguajë shitësit një pjesë më datë 30.06.2012 dhe pjesën tjetër më 31.12.2012. Pas lidhjes së kësaj marrëveshje i padituri ia ka paguar paditëse shumë prej 2000 €, ndërsa pjesën tjetër të borxhit i padituri ka marrë për obligim që ta kthejë deri më datën 31.12.2012. Poashtu i padituri disa herë i ka thënë paditëses se do t’ia paguajë borxhin dhe për këtë është duke tentuar që të merr kredi në ndonjë bankë e nëse nuk i lejohet kredia të njëjtin borxh to t’ia paguajë çdo muaj të paktën nga 500 euro, por që nuk iu është përmbajtur edhe këtij afati dhe deri më tani nuk ia ka paguar borxhin paditëses ( kjo është vërtetuar në bazë të CD-së së administruar si provë të cilën e ka ofruar i padituri si dhe nga dëgjimi i dëshmitares Xh. R.). Andaj, provave të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 423.3 të LPK-së, pasi që i autorizuari të paditurit - kundërpaditësit nuk ka marrë pjesë në seancën e datës 17.09.2014, edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mosprezencën nuk e ka arsyetuar.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 277 par.1 të LMD-së, pasi që i padituri është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditëses.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ashtu që paditëses i pranohen shpenzimet procedurale dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 135 € dhe për katër (4) seanca të mbajtura shumë prej 540 €, gjithsejt shumë e përgjithshme prej **675 €**,

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1140/12, datë 17.09.2014**

Sekretarja juridike  
Majlinda Shala

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.